

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skandali - Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ul ëta kundër VV-së
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919303/fjalimi-i-turpshem-ne-okb-berisha-rama-armik-i-eger-i-kosoves-tani-po-perhap-shpifje-te-uleta-kunder-vv-se/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 10:46:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 10:36:31 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7f463e57155def4799971e86e5c35e73f64d92508f94101b2a72c8168e6b8072
TEKSTI	acd3c0fb32e1443dc3d4283eb5dabae582b418100d02cc14ba5016d62b41c1e8
PAMJA	7d4685bde9f51e5d53fdaabd461961af39b5f7901fc36a3c80619bcd67e8ca9f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e56e777a7db9e8d503b67c26d78f29cf3d7bc6147af439d832205117a3e7372b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	2f94de55f91080d406fb9f0e4354ffa5a46214db9e0928186c4866f36bf6cd6f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e56e777a7db9e8d503b67c26d78f29cf3d7bc6147af439d832205117a3e7372b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



NDRIÇIM KULLA
Dorëheqja e Ramës, kërkesë
edhe e ndërkombëtarëve



ENVER BYTYÇI
Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!

LAJMI I FUNDIT

LIVE/ Kryetari i PD, Sali Berisha, bashkëbisedim me qytetarët në rrjetet sociale

më të lexuarat

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës',
Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste,
Rama s' menaxhon dot më

VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me
Ergys Agasin përmes telefonit të Vlorë
Hysenit?

Mashtrimi me shëndetësinë falas:
Shqipëria e dyta në Europë për koston e
lartë

Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë
dhe Elbasan dëshmuar se orteku i
opozitës po rritet çdo ditë

Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në
pikëpyetje sigurinë kombëtare të
Shqipërisë

'Garancia e plotë' e Ramës dhe
përgjegjësia e tij politike për Vlorë



Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së

12:36, 26/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Në një seancë pyetje-përgjigjesh me qytetarët, kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka komentuar fjalimin e kryeministrit Edi Rama në Asamblesë dhe Përgjithshme të OKB-së dhe qëndrimet e tij ndaj Kosovës dhe UÇK-së.

Berisha ka kritikuar ashpër Ramën, duke e akuzuar se nuk përmendi Kosovën dhe UÇK-në gjatë fjalimit në OKB. Ai ka folur gjithashtu për marrëdhëniet mes Tiranës dhe Prishtinës, duke kundërshtuar deklaratat se Lëvizja Vetëvendosje është kundër Shqipërisë dhe duke paraqitur qëndrimet e tij mbi rolin e qeverisë shqiptare në raport me Kosovën.

Pyetje-përgjigje:

Griselda Selimaj: Mirëdita Doktor. Si e vlerësoni mënyrën se si Rama e trajtoi çështjen e UÇK-së në mbledhjen gala? Ndërkohë në OKB nuk tha asnjë fjalë, duke u bërë edhe subjekt diskutimi në mediat e Kosovës.

Sali Berisha: Fjala e Padrinos në Organizatën e Kombeve të Bashkuara ishte fjala më e turpshme që është mbajtur ndonjëherë pas fjalimeve të ministrave të jashtëm të Shqipërisë apo atyre të Koresë së Veriut.

Nuk kemi pasur kurrë një përfaqësim kaq të turpshëm, ku kreu i narkoshtetit shqiptar, i fandaksur, i tmerruar nga protesta rinore, qytetare dhe skandalet e njëpasnjëshme, i kushtoi fjalën e tij algoritmit dhe tmerrit që ndjen nga algoritmi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Në këtë fjalim, në atë sallë e cila jo rastësisht, por në një akt përcërimi madhor ishte bosh gjatë fjalës së tij, Edi Rama nuk shqiptoi një herë të vetme fjalën Kosovë dhe fjalën UÇK apo lider të UÇK-së.

Tradhtia i ka zënë grykën. E ka mbërthyer për gryke dhe nuk e lejon më të

shqipëroje një ligje. Histori e turpsnime, në ato salla, në një ligjimi të shkelqyer, kryeministri i vendit mik, Kroacisë, foli sikur të ishte kryeministri i Shqipërisë. Ai denoncoi veprimet e Beogradit, nderimet ushtarake që i bëhen monstrave të gjenocidit të Bosnjës, Ratko Mlladiç, përpjekjet destabilizuese të Beogradit në Kosovë dhe për probleme të tjera të rajonit.

Kurse për Edi Ramën, universi i tij ishte algoritmi, që në fakt i ka kallur tmerrin dhe datën në çdo qelizë të tij.

Por, me këtë rast, i ftoj edhe ata pak qytetarë të Kosovës që për jugosllavizmin e tyre, apo për të mbetur si relike, apo për enverizmin e tyre, vazhdojnë dhe bëjnë të mashtruarin nga Edi Rama.

Të gjithë ata që duan Kosovën, kanë dhe kanë parë me dokumente, fakte të pakundërshtueshme se Edi Rama është një armik i egër i Kosovës, i demokracisë.

Miq, pas përpjekjeve për të rrëzuar qeverinë e Kosovës me Vlorë Hysenin dhe të dërguarit e tij, ai po përhap tani në Shqipëri shpifjet më të ulëta me të cilat kërkon të paraqesë Lëvizjen Vetëvendosje si një parti kundra Shqipërisë.

Unë u them këtyre puthadorëve të Edi Ramës, që paguhen si shërbëtorë të tij dhe kalojnë nga një studio në një studio tjetër me një mashtrim të paskrupullit, në Kosovë e vërteta është se nuk ka asnjë parti anti-Shqipëri.

Por ka një kryeministër në Shqipëri anti-shqiptar. Ka një kryeministër në Shqipëri, o çakej dhe puthadorë që ka ndërtuar në vendin amë, në Shqipëri, shtetin e drogës dhe ju pagan ju. Si mund ta akuzoni një parti sot në qeverinë e Kosovës se qenka kundra Shqipërisë?

Nuk ka asnjë parti në Kosovë kundra Shqipërisë, por natyrisht çdo shqiptar i ndershëm në Kosovë dhe kudo në botë është kundër narkoshtetit të Edi Ramës, dhe ju përdorni Shqipërinë si mburojë për narkoshtetin e Edi Ramës.

Turpi ju mbuloftë!

Nuk ka asnjë parti anti-Shqipëri në Kosovë, por ka një shqiptar që sillet si Pashiçi i Serbisë ndaj Kosovës, një shqiptar që quhet Edi Rama, argati i Vuçiçit.

Ju që dilni në studio o të pafytyrë dhe etiketoni anti-shqiptare partitë e Kosovës, harroni ju sanksionet që vuri kundër Kosovës i pari në Evropë?

Harroni ju xhiron ballkanike që bëri për të izoluar kryeministrin e Kosovës, ndërkohë që të tjerët i tregonin bërnylin, për kërkesën e tij, fqinjët e tjerë?

Harroni ju se si dorëzoi projektin e copëtimit të Kosovës? Harroni ju se si dorëzoi projektin e marrë në Beograd për Asociacionin?

Se si kërkoi konferencën ndërkombëtare për Kosovën në mënyrë që rusët të uleshin në tavolinë?

Si i lejoni vetes një gjë të tillë?

Ju me të njëjtin zell, të njëjtin shërbim i shërbeni Vuçiçit.

Ju jeni po kaq anti-shqiptarë sa Edi Rama, i cili s'guxon të përmendë fjalën Kosovë në OKB.

I cili nuk tha një fjalë të vetme për dënimin e tërë asaj udhëheqjes politike të Kosovës. Nuk shqiptoi një fjalë të vetme. Nuk ekzistonte për Edi Ramën ky problem.

Ky apatrid gjeti të bëhej patriot në një darkë ku sulmoi për tradhti Shtetet e Bashkuara dhe presidentin Joe Biden.

Joe Biden sot nuk është president, por u them shqiptarëve që në të gjithë karrierën e tij politike ai, qëndrimin dhe votën e ka patur për shqiptarët. Dhe del një zuzar dhe thotë se tradhtoi Joe Biden, meqenëse ai tani nuk është më në funksione.

Tradhtoi Amerika, Hashim Thaçin. Si mund të shqiptohet një fjalë e tillë? Me çfarë e tradhtoi Amerika Hashim Thaçin, a thoni pak njëherë?

Se çliroi Kosovën në bashkëpunim me UÇK-në?

Pra, praktikisht, ky Padrino i degraduar sot nuk ka asnjë interes tjetër vetëm karrigen e tij sepse e di që po i vjen fundi, fundi dhe fund i tmerrshëm.

Pse i tmerrshëm do thoni ju? Sepse ka firmosur në qindra vendime anti-ligjore.

Sepse është de facto drejtues i karteleve më të fuqishme të drogës në Evropë dhe ndër më të fuqishmet në botë. Sepse ka vjedhur miliarda në tendera, prokurime dhe pasuri publike

nyesumi

Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së

'Zullumi po e kap për fyti Ramën', Noka në Tepelenë: Skandalet e kanë zhveshur totalisht

'Qeveria braktisi qytetarët përballë çmimeve', aktivisti: Shqipëria mban TVSH-në 20% për shportën bazë

me pashë përherë

Nuk ka sot Evropa një të dytë të inkriminuar si Edi Ramën.

Ndaj dhe ai, jeni të përgatitur të dëgjoni çdo gjë gjersa të përfundojë në sallën e gjyqit.

© SYRI.net

Lexo edhe:



'Zullumi po e kap për fyti Ramën', Noka në Tepelenë: Skandalet e kanë zhveshur totalisht



Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuan se orteku i opozitës po rritet çdo ditë



Berisha: Vlora Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan

TË NGJASHME



Khixho: 400 miliardë lekë në vit në ndërtim, nga vijjnë paratë?



Eric Wendt, ambasadori i ri i SHBA-ve në Tiranë paraqet letrat kredenciale tek Bajram Begaj



Fjalimi në asamblenë e OKB -së edhe historia e Nuredin Xhakës!



Tradhtari ka vetëm një emër!



Asnjë fjalë për Kosovën në OKB, ndërkohë Rama përgatit rezolutë për mbrojtjen e homoseksualëve



Tabaku: Korrupsioni është taksa e fshehtë që paguan çdo shqiptar



Edi Rama po e keqpërdor Kosovën si lavatriçe për hallet e tij

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.